

VJOLLCA BELLI  
PETRIT BELLI

TA SHOHIM NË MËNYRË DIALEKTIKE ÇËSHTJEN  
E PËRCAKTIMIT TË PARIMEVE DHE RREGULLAVE  
TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Inisiativa e Institutit të historisë dhe të gjuhësisë për hartimin e një projekti të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, si dhe puna e kryer në këtë drejtim, duhet lavdëruar si një përpjekje dhe kontribut i shquar në detyrën e madhe, të rëndësishme dhe të ndërlikuar të normimit dhe njësimimit të gjuhës sonë.

Pasi studjuam me vëmendje projektin, si dhe vërejtjet e bëra nëpër diskutimet e ndryshme, kemi arritur në përfundimin se krahas zgjidhjeve të drejta e të padiskutueshme, që pa dyshim përfshijnë shumicën dërmuese të çështjeve, në projekt dhe në diskutimet nuk mungojnë edhe zgjidhje të padrejta e të pagoditura.

Për disa zgjidhje të tilla e për disa të tjera që nuk na duken të plota, si dhe për ndonjë çështje që nuk është trajtuar fare, dëshirojmë të çfaqim këtu disa nga vërejtjet dhe mendimet tona kryesore.

I

Së pari, mendojmë se në projekt i duhej lënë një vend më i madh përcaktimit të parimeve. Ato duhet të paraqiteshin dhe të argumentoheshin në mënyrë sa më të plotë, aq më tepër që ky nuk është manual për përdorim, por projekt për diskutim dhe, si i tillë, duhet të përmbante shpjegimet e nevojshme për të orientuar dhe lehtësuar diskutimet dhe zgjidhjen e çështjeve në mënyrë sa më të drejtë.

Në ç'raport qëndrojnë pra ndaj njëri-tjetrit parimi fonetik, si parim bazë, dhe parimi morfologjik, si plotësues? Mungesa e thellimit në këtë çështje kyç a nuk lë vend për subjektivizëm, siç ka lënë në fakt në disa zgjidhje të propozuara nga autorët e projektit, por sidomos nga disa diskutues? Një mungesë e tillë është shkaku i «përplasjes» së parimit fonetik me atë morfologjik në shumë çështje dhe raste, ose dhe i cënimeve të palejshme herë të njërit parim e herë të tjetrit.

Konkretisht, sipas parimit fonetik kemi: *i frikshëm, puntoria, antarsia, shumzim, pjestim, afrim, ja thashë troç, ju bë ferrë s'ëmës* etj., kurse sipas parimit morfologjik: *i frikëshëm, punëtorja, anëtarësia, shumëzim, afërim, ia thashë troç, iu bë ferrë* etj.

Pra si t'ia bësh? Cilën trajtë të zgjedhësh?

Lidhur me çështjet e kësaj natyre diskutantët janë ndarë në dy grupe: grupi i parë, me ata që janë për mbështetjen në parimin fonetik dhe grupi

i dytë, me ata që mendojnë se në përgjithësi parimi fonetik duhet t'i lëshojë më tepër vend atij morfologjiko-etimologjik.

Në vështrim të parë është zor të përcaktosh se cili grup ka të drejtë në rastin konkret. Prandaj çështja duhet shtruar në mënyrë dialektike.

Dy parime mund të bashkëveprojnë, kur nuk çenojnë dobinë e njëri-tjetrit në rolin e përbashkët. Le të vëmë në ballancën e arësytimit dobinë dhe dëmin që na vjen konkretisht në raste të tilla nga mbështetja në njërin ose në tjetrin parim dhe të shohim se cili peshon më tepër: dëmi apo dobia. Mendojmë se po të veprohet kështu me siguri rritet mundësia për zgjidhje të sakta.

Konkretisht, kur si parim bazë me të drejtë pranohet parimi fonetik, del se ruajtja e *ë-së* në raste si të mësipërmet stonon në mënyrë të dukshme me gjuhën e praktikës së përditshme, çënon pra në mënyrë të dukshme parimin fonetik, ndërsa, nga ana tjetër, morfema fjalë-formuese nuk çënohet kur kjo *ë* bie.

Duke e shtruar çështjen kështu, duket qartë se në raste të kësaj natyre fiton varianti fonetik: *puntoria, antarsia, i frikshëm, shumzim, pjestim*, etj.

Por gjithashtu nuk është vështirë të kuptohet se duke pranuar variantet fonetike: *ja thashë troç, ju bë ferrë s'emës* etj. në vend të: *ia, iu* etj., të cilat arbitrarisht zëvendësohen me *ja, ju*, çënohet jo vetëm rëndë, por dhe pa ndonjë arësyje, parimi morfologjik. Këtë e ka trajtuar mirë H. Nishani në gazetën «Mësuesi» të datës 18 gusht 1967 dhe ne e përmendim këtu vetëm për të tipizuar rastet e pranimit pa kriter të parimit fonetik si bazë për disa zgjidhje.

Ngritja e nivelit kulturalo-arësitor të të gjithë popullit kërkon me-demos edhe ngritjen dhe përsosjen e pareshtur të shkallës së njohjes shkencërisht të gjuhës si mjet komunikimi.

Mirëpo, kur duam p.sh. t'u trajtojmë dëgjuesve ose lexuesve tanë nga pikpamja morfologjiko-etimologjike fjalët *byro, burokrat, burokratik, burokraci, burokratizim* etj., pasi shpjegojmë se fjala *byro* vjen nga frëngjishtja *bureau* (zyrë) dhe se fjala *burokrat* vjen nga fjala e mësipërme frënge *bureau* dhe ajo greke *kratos* ( *κρατος*: pushtet), mendojmë se, me gjithë punën e mirë të bërë kështu, dëgjuesit apo lexuesit tanë ose nuk do ta kapnin drejt dhe plotësisht çështjen, ose do ta kapnin me vështirësi, dhe kjo, për mendimin tonë, vetëm për shkak të ndryshimit pa arësyje të vërtetë që pëson morfologjia e fjalës *byro* në rrjedhojat (derivatet) ose fjalëformimet, duke u kthyer në *buro: burokrat, burokraci* etj., duke bërë kështu që *byro* dhe *buro* të na duken dy gjëra të ndryshme, pa lidhje, ndërsa janë vetëm një dhe po ajo gjë.

Përkundrazi, shumë më lehtë dhe më qartë do të mund të trajtohej dhe kuptohej çështja sikur të shkruanim: *byro, byrokrat, byrokraci* etj.

Si çështje, këtë me të drejtë e ka prekur edhe L. Dodbiba në revistën «Studime filologjike» Nr. 2, 1968, f. 171 dhe ne, siç del, jemi për të njëjtën zgjidhje, por e shtjelluam këtu për të argumentuar jo vetëm nevojën e marrjes parasysh të saj në rregullat që do të hartohen, por — duke e përgjithësuar si çështje — edhe për të provuar se kriteri i mbështetjes në traditën fonetike të shqiptimit nuk mund të përdoret kallëp, përkundrazi, në raste konkrete duhet parë edhe në mënyrë kritike: në se çënon ndonjë gjë dhe në ç'masë: të pranueshme apo të papranueshme.

Por çështjet dhe rastet janë të shumta dhe të shumëllojshme dhe, për të arritur në zgjidhje të drejta, duhet të kuptojmë drejt raportin e bashkëveprimit të të dy parimeve.

Ekstremizmi në këtë mes, qoftë dhe për çështje të veçanta, do të ishte mjaft i dëmshëm, sepse mbivlerësimi i parimit fonetik me kohë bën që drejtshkrimi të zhvillohet në mënyrë të tillë, që nuk do të ishte në pajtim me vetë synimin për normimin, njësimin dhe kristalizimin e gjuhës.

## II

Një çështje tjetër, gjithashtu me rëndësi të dorës së parë, mendojmë se është edhe zgjedhja midis dy, tri ose shumë varianteve dialektore të shqiptimit. Për të mos i lënë vend subjektivizmit në zgjidhjen e kësaj çështjeje, duhet ta shtrojmë atë në mënyrë dialektike.

Duhet theksuar se ne po e shqyrtojmë çështjen e përcaktimit të parimeve dhe rregullave të drejtshkrimit në kohën kur është kristalizuar ose po përfundon kristalizimi i normës letrare kombëtare.

Kështu, kur është dashur zgjedhja midis dy ose më shumë varianteve të shqiptimit të një fjale të caktuar, autorët e projektit kanë zgjedhur variantin që mendojnë se është i shqiptimit më të përgjithshëm. Mirëpo ja që në aspektin konkret jo të gjithë janë të një mendimi për atë që është quajtur si «e shqiptimit më të përgjithëshëm» në projekt dhe lidhur me këtë kanë dalë diskutime të shumta; disa propozojnë: *rrjep, nxjerr, lëngëra, shemër, zhvendos, blokoj, nënuaj* etj., ndërsa të tjerët: *rjep, nxjer, lëngje, shemër, çvendos, bllokoj, nënoja* etj. Pra kush ka të drejtë?

Sikur të ishte fjala për fare pak raste të tilla, zgjidhja nuk do të ishte një punë e vështirë dhe ndoshta nuk do të paraqiste interes për trajtim. Mirëpo është fjala për një varg rastesh. Nga diskutimet nuk del gjithnjë se cila mund të merret si zgjidhja më e drejtë dhe kjo, sipas nesh, sepse në raste të tilla nuk bazohemi në kritere të përcaktuar qartë, ose më mirë të themi nuk u përmbahemi kritereve bazë të pranuar.

Kështu p.sh., në paragrafin 19, f. 58 të projektit thuhet: «Fjalët dhe emrat e përveçëm, që në gjuhët e burimit përmbajnë një *l* të thjeshtë ose dyfishe, do të shkruhen me *l* e jo me *ll*» dhe vijnë shembujt: *alfa, alfabet, ambulancë, Apolonia, blok, blokadë, kolos* etj. Pastaj: «Do të shkruhen me *ll* fjalët dhe emrat e përveçëm: *Ballkan, ballkon, basketboll, bullgar, çokollatë, futboll, galloshe, kontrolloj* etj.»

Vëmë re se fjalët *alfabet, ambulancë, ballkon, kontrolloj* etj. në gjuhët e burimit të gjitha kanë *l* e megjithatë disa prej tyre në ligjërimin e përditshëm shqiptohen me *l*, kurse disa me *ll*, duke bërë kështu përjashtim nga rregulla e mësipërme. Kjo gjendje pranohet dhe në projekt, por nuk thuhet se mbi ç'kriter bazohen ky dhe të tjerë përjashtime, sepse në qoftë se për këtë me të drejtë bazohemi në shqiptimin në të përgjithshëm, atëherë përse nuk veprohet po kështu edhe për fjalët: *Apollonia, bllok, bllokadë, tablo* etj.

Kurse në paragrafin 20, f. 59 nuk na duket i drejtë kriteri i zgjedhur për shkrimin e fjalëve të reja të burimit sllav, si dhe të emrave të përveçëm të po këtij burimi, sipas të cilit ata «...pavarësisht nga mënyra e shqiptimit të *l*-së në gjuhët përkatëse, do të shkruhen përgjithësisht me *ll*».

Së pari, nuk na duket të ketë arsye bindëse për të dalluar nga njëra anë emra të tillë si: *Pavlllov, Vollodja, Llunaçarski, Llobaçevski, Rusllan* etj. dhe nga ana tjetër: *Vollga, Bjellorusia, sllav* etj., duke i shkruar në shqipe të parët me *ll* kurse të dytët me *ll*, sepse në qoftë se është fjala për «shqiptimin më të përhapur» nuk gabojmë po të themi se ky është i njëllajtë për të gjithë këta emra: të gjithë shqiptohen me *ll*.

Së dyti, dhe kjo është kryesorja, shumicën dërmuese të fjalëve të reja të burimit sllav si dhe emrat e përveçëm të po këtij burimi mund të themi se në përgjithësi tashmë kemi mundur t'i njohim drejtpërsëdrejti nga gjuhët përkatëse (pavarësisht nga mënyra: transmetim gojor apo letrar). Për këtë arsye, si dhe për shkak të aftësive të plota që ka gjuha shqipe për t'i paraqitur drejt fjalët dhe emrat sllavë qoftë me gojë, qoftë me shkrim, tradita e formuar e shqiptimit të fjalëve sllave të kësaj natyre me *ll* ose *l* bazohet në shqiptimin që i bëhet në gjuhën burim; prandaj nuk na duket me vend ta ngatërrojmë çështjen duke i ndarë në dy grupe (me *ll* dhe me *l*) emrat dhe fjalët që në gjuhët përkatëse shqiptohen një-lloj me *ll*.

Mendojmë pra se kriteri për zgjidhjen e çështjes në fjalë duhet të mbështetet mbi këtë bazë dhe atëherë del se në fjalët dhe emrat e mësipërm do të ruhet tingulli përkatës *l* ose *ll* dhe se do të bëjnë përjashtim vetëm disa emra, të tillë si: *kolkoz*, *Bajkal*, *Lomonosov* etj., të cilët ndonëse në gjuhën mëmë (ruse) shqiptohen me *ll*, me sa duket i kemi njohur jo drejtpërdrejt nga gjuha përkatëse, por nëpërmjet gjuhësh të tjera, që nuk e kanë tingullin *ll* (nga frëngjishtja ose italishtja) dhe tashmë është bërë zakon të shqiptohen kështu prej të gjithëve.

Dhe tani do të radhisim më poshtë konkretisht çështjet kryesore që na u dukën të diskutueshme, si dhe zgjidhjet përkatëse që propozojmë dhe që, sipas nesh, të bazuara mbi kritere të zgjedhura në mënyrë dialektike, besojmë të jenë të drejta:

## 1.

Mendojmë se në rregullat e drejtshkrimit duhet përfillur edhe prirja e dukshme që vihet re kohët e fundit në gjuhën e folur për përdorimin e ë-së së theksuar të toskërishtes në një serë fjalësh, si:

*brënda*, *dhëmbje*, *gdhë*, *gdhëndës*, *dhëntë*, *gjëmb*, *gjëndje*, *vënd*, *kuvënd*, *shëmër*, *shëmbëll*, *tëndë*, *trëmb*, *thëmbër*, *zëmër* (shih A § 1), duke e ruajtur këtë ë edhe kur ajo e humbet theksin në trajta të tjera të emrit, p.sh.: *dhëmbsuria*, *tëndosje* etj. në vend të: *brenda*, *dhembje*, *gdhe*, *gdhendës*, *gjemb*, *gjendje*, *vend*, *kuvend*, *shemër*, *shembëll*; *tendë*, *tremb*, *thembër*, *zemër* etj.

## 2.

a) Në përgjithësi thuhet:

*Lip*, *lipsar* (*lipës*), *lipset* etj., dhe jo *lyp*, *lypsar*, *lypset* (BI-13); (*i*, *e*) *grynjtë* dhe jo (*i*, *e*) *grunjtë* (BI § 14); *dyll* (si *pyll*) dhe jo *dyllë* (BII § 9); *qurre* (si *shkurre*) dhe jo *qurra*; *guzhinë* (*guzhinier*) dhe jo *kuzhinë* (*kuzhinier*) (shih CI § 10) etj., që do t'i shohim dora-dorës.

## 3.

Përsa i përket heqjes së ë-së në trajtën e shquar njëjës e shumës të emrat dhe mbiemrat më *-ël*, *-ër* dhe *-ërr*, propozuar nga shokët e Pogradecit në gazetën «Mësuesi» të datës 4 janar 1969, duke menduar se gjoja kështu do të thjeshtohet shumë rregulla për shkrimin e ë-së në fjalët me *-ër* dhe *-ërr* dhe se gjoja është në pajtim me shqiptimin më të përgjithshëm. Mendojmë se, përkundrazi, ruajtja e saj në të pashquarën e njëjësit dhe pastaj heqja e saj në të gjitha trajtat e tjera e ndërlikon drejtshkrimin e fjalëve dhe rregullën përkatëse.

Prandaj mendojmë se ruajtja e -ë-së në të gjitha trajtat jo vetëm që është në pajtim me shqiptimin më të përgjithshëm, por e thjeshton dhe e lehtëson çështjen e drejtshkrimit të fjalëve përkatëse, si më poshtë:

P.sh. *dhel-për-dhel-përa-dhel-përat; i gjelbër, i gjelbëri, të gjelbërit, gjarpër-gjarpëri-gjarpërinjtë, i verbër, i verbëri, të verbërit*. Kurse, siç propozohet prej shokëve të Pogradecit, heqja e -ë-së, përveç ndërlikimit të rregullës, çon dhe në vështirësi shqiptimi: *i kaltri, të kaltrit, gjarpri, gjarpërinjtë, i verbri, të verbrit* etj.

## 4.

Përsa i përket çështjes së drejtshkrimit të fjalëve ku takohen sipas rastit, *s, z, d, t* me *h*, pa më të voglin ngurim jemi për përdorimin e vizës ndarëse (—), kryesisht për këto dy arsye:

a) mospërdorimi i saj, në rastin më të zakonshëm, çon në perceptimin e tyre si një bashkëtingëllore e vetme: *sh, zh, dh, th* dhe, rrjedhimisht, në leximin e keq të fjalës: *meshollë*, si t'ishte *me shollë* dhe jo siç duam të themi: *mes-hollë*.

b) E keqja e dytë është se, në vend të një rregulle të vetme: vënjen e vizës ndarëse, sipas variantit të projektit kemi nevojë për dy rregulla: një që porositi t'i shkruajmë bashkë këto takime bashkëtingëlloresh, dhe tjetra që porositi për të pasur mendjen paraprakisht për të mos i lexuar me *sh, zh, dh, th*, por ndaras: *meshollë = mes-hollë, Ethem = Et-hem* etj. Midis apostrofit dhe vizës ndarëse zgjedhim këtë të fundit, për arsye se kjo e realizon veçimin më qartë, më lehtë dhe nuk ngatërrohet me rolin e apostrofimit.

Sa për variantin me pikë (.) mbi gërmat *s, z* (*sh zh*) dhe nën gërmat *d, t* (*dh, th*) propozuar nga L. Dodbiba në revistën «Studime filologjike», Nr. 2. 1968, mendojmë se nuk ja vlen të diskutohet.

5. Jemi për ruajtjen e *c* dhe *ç* nistore në disa nga fjalët ku, megjithëse këto gjenden para zanoreve ose bashkëtingëlloreve të tingullta, ato (*c* dhe *ç*) janë të qarta, *ç*-ja shpreh më mirë veprimin e kundërt dhe secila jo vetëm që është eufonike në tërësinë fonetike të fjalëve që do të përmendim, por dhe është në pajtim me shqiptimin më të përgjithshëm:

a) *cfurk, cfrat, cfilit, cmirë* dhe jo *sfurk, sfilit, sfrat, smirë*,

b) *çfajësoj, çfaros, çfletoj, çfrej, çfrenoj, çfrytëzoj, çfuqizoj, çkombëtarizoj, çkurdis, çkurorëzoj, çpikje, çpifje, çpërvesh, çpoj, çpronësoj, çpyllëzoj, çvendos, çbllokoj, çdëmtoj, çdoganoj, çvleftësoj, çvulos, çnjolloj, çnderoj* dhe jo: *shfajsoj, shfaros, zhvendos* etj. sipas projektit as edhe *xhvendos* (sipas shokëve të Durrësit shih «Mësuesi» 12.II.1969), dhe as *zhbllokoj, zhdëmtoj, zhdoganoj, zhvleftësim* etj. (sipas projektit).

Gjithashtu, në përputhje me parimin e shqiptimit më të përgjithshëm jemi për variantet: *xhvat, xhvësh*, dhe jo: *zhvat, zhvësh*.

## 6.

Emrat që mbarojnë me *-o-* mendojmë se duhen ndarë në dy grupe:

A. Ata që mbarojnë me *-o-* të patheksuar: të tillë si: *Armando, Bato, Damo, Deko, Dino, Dito, Foto, Gaço, Halo, Koço, Kristo, Miho, Nalo, Otello, Piro, Sako, Vito, balo, gusto, kallo, kosto, manto, pako, pallto, teto, torno, xhaxho, xhiro* etj., këta në emëroren e shquar të njëjës-it në pajtim me shqiptimin më të përgjithshëm, do të marrin mbaresën *-ua*:

*Dinua, Koçua, Sakua, balua, tetua, kostua* etj.

Nuk na duket i vërtetë pohimi i P. Gecit (shih revistën «Studime filologjike» Nr. 2, 1968, f. 181) se gjoja trajta me *-ja* (*Kristo-ja*, *Pirro-ja* etj. mbizotëron, dhe ca më pak ai i L. Dodbibës (po aty, f. 173) se gjoja kjo trajtë «... është më e përgjithëshme, arrin gjer në Shqipëri të Mesme».

Përkundrazi, na duket krejt e vërtetë se kjo trajtë është thjesht dialektale e viseve jug-lindore të vendit. Shih S. Spasse «Ata nuk ishin vetëm», f. 65-66: «... Se mos fitonte gjë Rakoja!»; «... se mos kishte ndonjë faj *Rakoj*.» etj. (po aty f. 66). Dhe bile kemi vënë re se edhe brenda vetë këtij perimetri relativisht të ngushtë jo gjithnjë janë konsequentë; kurse nuk është aspak e vështirë të vihet re se ajo që mbizotëron në mënyrë të dukshme, në gjuhën e sotme letrare është trajta me *-ua*.

B. Ata që mbarojnë me *-o* të theksuar,

a) emra mashkullorë që mbarojnë me *-o* të theksuar, si p.sh. *Bualo*, *Didëro*, *Dritëro*, *Go Mo Zho*, *Guno*, *Mirabo*, *Pikaso*, *Shato-Rëno*, *Xho* etj., të marin *-i* kur shquhen: gjeneral *Didëroi*, *Dritëroi*, *Miraboi*, *Xhoi* etj.

b) emra femërorë që mbarojnë me *-o* të theksuar: si *Arsino*, *Kaliro*, *byro*, *domino*, *liko*, *metro* etj. do të marrin *-ja* kur shquhen: *Arsinoja*, *Kaliroja*, *byroja*, *likoja*, *metroja* etj., kurse emrat: *Argjiro*, *nëno*, dhe *tabllo*, të cilët diku shqiptohen me *-o* të theksuar e diku me *-o* të patheksuar, mendojmë se duhet të kenë vetëm variantin e parë dhe, rrjedhimisht, nuk do të kemi herë *Argjirua*, *nënua*, *tabllua*, herë *Argjiroja nënoja* (*s'më lë nënoja*), *tablloja*, por do të kemi vetëm këtë variantin e fundit, d.m.th. me *-ja*, duke i përfshirë edhe këta në emërat femërorë që mbarojnë me *-o* të theksuar.

7. Lidhur me *-ll-* në trup të fjalës kemi këtë vërejtje:

Në pajtim me shqiptimin më të përgjithshëm kemi:

*Apollóni* (hyu grek), *Apollonia*, *Atlantiku*, *Atlantida*, *atlas*, *ballonë*, *bllok*, *bllokadë*, *bllokoj*, *bullonë*, *falls*, *fallsifikim*, *kloun*, *llovari*, *spekullim*, *tabllo*, *Jallta*, *Rusllani*, *Ludmilla*, *Millosh*, *Llobaçevski*, *Sverdillov*, *Vollodja*, *Llunaçarski*, dhe jo me *-l-*, si në f. 59 të projektit: *Apolonia*, *Atlantik*, *Atlas*, *balonë*, *blokadë*, *blokoj*, *bulonë*, *fals*, *kloun*, *spekulim*, *tablo*, *Ludmila*, *Ruslan*, *Volodja* etj. Gjithashtu: *pëllcisni*, (si *gëlltisni*) dhe jo *pëlcisni*. Por *marmalatë* dhe jo *marmallatë*.

8.

Lidhur me disa fjalë me *-rr-* (CI § 7. f. 45), jemi të mendimit që:

a) foljet *mar*, *nxjer*, *përmjer*, të shkruhen në çdo trajtë kohore me *-r-* dhe jo me *-rr-*, siç propozohet në projekt: *marr*, *nxjerr*, *përmjerr* etj.

Së pari, sepse kështu thjeshtojmë ose më saktë shmangim rregullën sipas së cilës këto folje në të kryerën e thjeshtë duhen shkruar me *-r-*, kurse në kohët e tjera me *-rr-*: *marr*, *merrja*, dhe pastaj *mora*, *more*, *mori*; *nxjerr*, *nxirrja*, dhe pastaj *nxora*, *nxore*, *nxori*; po ashtu: *përmjerr* etj. rregull e cila e ndërlikon dhe e vështirëson zgjedhimin dhe praktikën e përdorimit korrekt me gojë e shkrim të këtyre foljeve.

Së dyti, sepse mendojmë se në këtë rast, po ashtu si në të kryerën e thjeshtë, edhe në kohët e tjera tingulli *rr* nuk është as domosdoshmëri dhe as një nevojë e vërtetë morfologjike ose fonetiko-eufonike dhe pra fare mirë mund të zëvendësohet me *r* në çdo kohë, d.m.th.: *mar*, *merja*, *mora* etj. *nxjer*, *nxirja*, *nxora* etj. Ndoshta do t'ja vlente, për hir të thjeshtë-

timit të rregullave, të duronim vështirësitë e fillimit, sa të mësoheshim me trajtat e reja.

Edhe fjala *zhavorr* mendojmë se përgjithësisht shqiptohet *zhavor*.

b) Tashmë është bërë shprehi për të gjithë pothuaj që fjalët e reja që kanë ardhur nga gjuhët romane dhe që kanë *-rr-* në gjuhët përkatëse, të përdoren përgjithësisht me *r* në gjuhën shqipe. Kështu p.sh. themi: *arri-vist, arrestoj, arrogancë*, por themi: *hemorragji, karierist, korelim, korespondencë, koridor, taracë* etj. dhe jo: *hemorragji, korrespondencë, korridor, tarracë* etj. Duke propozuar ruajtjen e *rr-së* te të gjitha fjalët e këtij lloji autorët e projektit, me sa duket, nisen nga qëllimi i mirë i përgjithësimi të rregullës, por mendojmë se kjo rregull ndodhet tashmë para një tradite të caktuar në shqiptimin e këtyre fjalëve, dhe nuk mund të mos e marrë pa-rasysh këtë traditë.

9. Lidhur me rastet e takimit të shkronjave *g* ose *n* dhe *j*, për të më-njnuar shqiptimin e këtyre dy shkronjave si një e vetme (*gj* ose *nj*, sipas rastit), duke qenë i vështirë përceptimi dhe prandaj dhe leximi i tyre veças qysh me vështirimin e parë mendojmë se zëvendësimi i *-j-së* me *-i-* jo ve-tëm që e plotëson këtë kusht pa e cënuar fjalën nga pikpamja e morfolo-gjisë dhe e bukurzanisë, sepse shqiptimi i diftongjeve *ia, ie, io, iu* është shu-më i përafërt me *ja, je, jo, ju*, që duam të ruajmë, por edhe paraqitja dhe përvetësimi i kësaj rregulle na duket se arrihet më lehtë:

Sa për variantin e futjes së *-ë-së* midis *g-së* (ose *n-së*) dhe *j-së* (*lagëje*, *rënëje* etj.), që është propozuar nga disa diskutantë, ky na duket edhe i pa-drejtë edhe i panevojshëm. Ca më i papërshtatshëm na duket varianti me pikë (.) mbi *g* dhe *n*, i propozuar nga L. Dodbiba në revistën «Studime fi-lingjike» Nr. 2, 1968.

10. Lidhur me fjalën *një*, si pjesë përbërëse në numërorët rreshtorë, mendojmë të shkruhet: *i njëzetënjëjti, i gjashtëdhjetënjëjti* etj., sikurse (*i*) *njëjti*, që, pavarësisht se në këtë trajtë është në rolin e mbiemrit, vjen nga numërori themelor *një* dhe në këtë mes, në qoftë se jemi për vendosje rregullash sa më të përgjithshme, s'kemi përse të shkruajmë: *i njëzetënjëjti* etj. siç propozohet në C I § 5/6.

11. *c* apo *ç*?, *q* apo *k*?, *t* apo *th*?, *gn* apo *nj*?, *gj* apo *xh*?

a) Mendojmë se fjalët me burim latino-roman, të cilat në gjuhën ori-gjinale kanë *c* të pasuar nga një *i* ose *e*, jo të gjitha duhen shkruar me *c*, siç propozohet në projekt (pika 10, f. 54). Duke u bazuar në traditën e de-ritanishme të shqiptimit, pas futjes në shqipe të këtyre fjalëve, kemi: *cer-tifikatë, konçesion, procedurë, procesion, saraçenët, çiklamin, çisternë, defi-çit, klasiçizëm, publicistikë* etj. Po ashtu: *biçikletë, çimento* etj. dhe jo *cer-tifikatë, konçesion, saracenët, cimento* etj.

b) Mendojmë se do të ishte më drejt të shkruanim: *makinë, makineri, makinacion, Siçili, siçiljane* etj. dhe jo *maqinë, Siqeli*, etj. (f. 55).

c) Mendojmë se për një numur fjalësh të burimit grek, të cilat sipas traditës së deritanishme të shqiptimit në shqipe paraqiten me *th* nuk ve-prohet drejt kur zëvendësohet *th-ja* me *t*: *arithmetikë, skithët, Skithia, Ko-rintheta, Thesalia, Thesprotët, Thrakia, mith*. Këto stonojmë shumë po të shqiptohen me *t*, p.sh. *arimetikë, skit, Tesali, mit* etj. po ashtu si do të stononin: *Atinë, Temistokli, Tanas* etj. sikur të tentonim t'i shkruanim kështu, në vend të: *Athinë, Themistokli, Thanas* etj.

d) Jo *inkognito, magnat, magnolia*, sikurse shkruhen në gjuhët prej nga rrjedhin, por *inkonjito, manjet, manjole* etj. (d.m.th. me *-nj-* sikundër

lexohen në italisht). Krejt e kësaj natyre është dhe fjala injorant (në italisht *ignorante*), prandaj nuk na duket të ketë arësye të vërteta për të bërë dallim midis kësaj fjale dhe gjithë të tjerave të së njëjtës natyrë, duke pranuar që kjo të shqiptohet dhe shkruhet me *-nj-*, kurse gjithë të tjerat me *-gn-*.

e) Mendojmë se tradita e deritanishme nuk pranon që fjalët: *giboni*, *xhira*, *xhiro*, *xhirim*, *xhenjo* (si *dizenjo*), dhe *xhongler* të shkruhen: *gji-boni*, *gjirafa*, *gjiro*, *gjirim*, *xhenio*, *zhongler*, siç propozohet nga disa diskutues të Shkodrës. Gjithashtu mendojmë se në projekt trajtat *dezorientim* dhe *regjisor* duhen zëvendësuar me *çorientim* dhe *regjizor*.

12. Lidhur me disa veçori të shumësit të disa emrave dhe mbiemrave, mendojmë se sipas shqiptimit më të përgjithshëm kemi:

a) *nyjet*, *pjeshkët*, *shegët*, *gjymtyrët*, *lëkurat*, *detyrat*, *urat* (*urat e zjarrit*) etj. dhe jo *nyjat*, *këmishët*, *gjymtyrat*, *lëkurët*, *detyrët*.

b) *mishra të pjekur*, dhe jo *mishra të pjekura* etj. Në këtë çështje pajtohemi me mendimin e shokëve të Durrësit në gazetën «Mësuesi», të dt. 12.II.1969 etj.

Pra: *brigje të thepisur*, *lëngje tretës*, *puse të thellë naftë-gaz-mbajtës*, *kanale vaditës* etj., dhe jo *lëngje tretëse*, *puse të thella*, *kanale vaditëse* etj. Natyrisht nuk mund t'i nënshtrohen këtij rregulli raste të kësaj natyre: *suksese të dukshme*, *rezultate të mira* etj.

### 13.

Por nuk pajtohemi me mendimin e shokëve diskutantë të Durrësit lidhur me:

a) futjen e *-j-së* te folja *pi*. Sipas tyre: *pij*, *pi*, *pi*, *pijmë*, *pini*, *pijnë*, *pijnim*, *pijnit*, *pijnin* etj. Pa shumë koment, kjo ka dy të këqija: ndërlikon rregullën e drejtshkrimit të kësaj foljeje dhe vështirëson shqiptimin. Po për të njëjtën arësye mendojmë që edhe folja *pajis*, që vjen nga fjala *pajë*, të shkruhet *pais*, *paisje* etj.

b) Nuk pajtohemi me propozimin e tyre për futjen e *-ë-së* në mes të fjalëve *kurrfarë*, *kurrkush*, *kurrsesi* etj. (sipas tyre: *kurrëfarë*, *kurrëgjë*, *kurrëkush*, *kurrëqysh*, *kurrësesi*, *kurrëkund* etj.). Këtu, po ashtu si te fjalët *punëtorja*, *anëtarësia pjesëtimi*, *shumëzimi* etj. zbatimi i parimit morfologjik përplaset (në se mund të kemi kështu) me prirjen fonetike.

c) Nuk pajtohemi me propozimin e tyre për heqjen e *-e-së* parafundore në rastet e tipit *deleje*, *artisteje*, *dritareje* etj. që çënon pa ndonjë nevojë të fortë traditën (sipas tyre: *kujtim prej një artistje*, *drita vinte përmes një dritare* etj.).

d) Gjithashtu nuk na duket i drejtë propozimi i po këtyre shokëve për zëvendësimin e *-nj-ës* me *-j* te emrat e tipit: *arinj*, *ftonj*, *florinj*, *përrrenj*, *lumenj* etj. (sipas tyre: *arj*, *ftoj*, *florij* etj.) as propozimi i S. Xhangos dhe R. Sadirajt për ruajtjen e trajtave thjesht lokale: *narçot*, *kaninjot*, në vend të *nartiot*, *kaniniot*, sikurse: *borshiot*, *himariot*, *kuçiot* etj. trajta këto më të përgjithshme dhe më të përshtatshme nga çdo pikëpamje.

### 14.

Në rastet e tipit: *nxënëses më të pastër*, *pioneres më të mirë*, *punëtores më të dalluar* etj., kur mbiemri i shkallës sipërore relative kalon para emrit, nuk e quajmë të nevojshme dhe as në pajtim me praktikën e deritanishme zëvendësimin e nyjes së përparme të me së siç veprohet në pro-

jekt: *më së mirës nxënëse, më së dalluarës punëtore* etj. Kështu jo vetëm që shtrembërojmë traditën e rregullt, por dhe nxjerrim nevojën e paqenë të formulimit të dy rregullave. Prandaj mendojmë që në këto raste nyja e përparme të të mbetet e tillë qoftë kur mbiemri vjen pas emrit, qoftë dhe kur ky del para tij, d.m.th. «*Hartimi i më të mirës nxënëse; iu dha më të mirës punëtore.*»

15.

Përsa i përket paragrafit 17 në f. 68 të projektit, ku bëhet fjalë për drejtshkrimin e përemrave pronorë, jemi dakord me propozimin që paraqitet aty për të shkruar pa nyje të përparme përemrat pronorë *im, ime, yt, jote, ynë, jona, juaj* dhe gjithë trajtat e tyre kur përdoren vetëm, si p.sh.: *libri im, djali yt, vendi ynë* etj., por nuk pajtohemi me propozimin për mospërdorimin e nyjes së përparme edhe në rastet kur këta përemra përcaktojnë një emër: «*ky libër është imi*», «*kjo punë është imja*», «*yt është ky djalë?*», «*vajza e saj është guximtare*» etj.

Mendojmë se në të folurit e përditshëm kemi:

*Ky libër është i imi, kjo punë është e imja, i yti është ky djalë* etj. dhe veç kësaj, nuk na duket të ketë ndonjë arsye të vërtetë për të mos e përdorur edhe këtë e tutje nyjen e përparme në raste të kësaj natyre.

16.

Lidhur me çështjen e apostrofit mendojmë se ky duhet përdorur, veç të tjerash, edhe për apostrofimin e -ë-së së pazëshme në fund të fjalëve, kur pas tyre vjen nyja e ose i: *ky djal është shumëizoti; vajz'e rregullt; qep'e njomë; nën'e dashur* etj., në vend të: *ky djal është shumë i zoti; vajzë e rregullt; qepë e njomë; nënë e dashur* etj. Përveç që bën të paraqiten korrekt nga pikëpamja e vlerës fonetike fjalët e këtyre rasteve, mendojmë se edhe praktika e përdorimit të apostrofit në këtë rast nuk paraqet asnjë vështirësi.

17.

Lidhur me kapitullin e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shënojmë se ndërsa me të drejtë në projekt propozohet të shkruhen si një fjalë: *tejpërtej, drejtpërdrejt, hëpërhë* përse propozohet të shkruhen ndaras rastet e ngjashme: *pikë për pikë, sy për sy, vit për vit* etj. Lidhur me këtë mendojmë se lokucionet ndajfoljore të formuara nga dy gjymtyrë të njëjta, që lidhen me parafjalët *mbi, më, nga, na, pas, për*, ose me lidhësen -e- jo vetëm duhen shkruar si një fjalë por, në përshtatje me shqiptimin më të përgjithshëm dhe më të përshtatshëm -ë-ja fundore e gjymtyrës së parë të lokucionit duhet të bjerë: *gushë më gushë = gushmëgushë, buzë më buzë = buzëmëbuzë* dhe kështu me radhë: *dormëdorë, dorpërdore, pikpëpikë* etj.

Pastaj: *atypëraty, mespërmes, brezpasbrezi, motpërmot, krahpërkrah, motejetë, rretheqark, veçeveç* etj. Gjithashtu mendojmë se edhe lokucioni në qoftë se ndoshta do t'ishte më mirë të shkruhej si një fjalë: *nëqoftëse*.

Po ashtu: *përqind, përqindje*, por: *pesë përqind; tetë përqind, 30 përqind, 2,5 përqind, 90 përqind* etj. Vetëm 100% të shkruhet një fjalë *qindpërqind*.

18.

Përsa i përket vizës ndarëse mendojmë se ajo duhet përdorur edhe në fjalët e përbëra, kur leximi i tyre është i vështirë, si p.sh. rastet: *shtresë*

naftëgazmbajtëse, rrëshirë, fenolformaldehidlignosulfonatike, ferrokromlignosulfonat etj. Prandaj do t'ishte më mirë të shkruhej: shtresë naftëgazmbajtëse, rrëshirë fenolformaldehid-lignosulfonatike, ferrokromlignosulfonat etj., por ndarja duhet bërë sipas një kriteri të arësyeshëm: ruajtja e njërive fjalëformuese. Gjithashtu mendojmë se ajo duhet përdorur edhe në fjalët e përbëra, ku bashkërenditen radhazi dy *r* ekstreme, *r* dhe *rr*, ose dy *rr*, si p.sh.: *kundërrevolucion*, *kundërrryma*, *derrrritës* etj.. Kështu pra do të kemi: *kundër-revolucion*, *kundër-rryma*, *për-rreth*, *derr-rritës*, *bakërr-rrahësi* etj.

19.

Lidhur me përdorimin e shkronjave të mëdha kemi këtë vërejtje:

Në emërtimet zyrtare të institucioneve shtetërore lokale, mësimore, administrative, shkencore dhe kulturele; të ndërmarrjeve dhe enteve etj., mendojmë se në çdo rast të gjitha fjalët duhen filluar me shkronjë të madhe, për arsye se kemi të bëjmë me njësi të caktuara, të veçanta. Njëkohësisht, kështu shmangim edhe nevojën për dy ose më shumë rregulla, që e vështirësojnë çështjen, duke i ndarë në dy a më shumë grupe organet dhe entet lokale, siç propozohet në projekt, gjë që nuk na duket një nevojë e vërtetë. Pra, sipas nesh, duhet shkruar: *Universiteti Shtetëror i Tiranës*, *Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë* etj. dhe jo *Universiteti shtetëror i Tiranës*, *Fakulteti i historisë dhe i filologjisë* etj.

Po ashtu nuk na duket bindëse se përse te emërtimet e festave, kur fillojnë me fjalë, vetëm terma e parë të nisë me shkronjë të madhe, kurse e dyta me të vogël, ndërsa kur fillohet me shifër atëhere terma e dytë të shkruhet me të madhe, d.m.th. *Një maji — 1 Maji, Tetë nëndori — 8 Nëndori* etj. Kjo e ndërlikon çështjen më kot. Mendojmë pra se në të dy rastet duhet filluar me shkronjë të madhe: *Një Maji — 1 Maji, Tetë Marsi — 8 Marsi* etj.

20.

Veç sa thamë, mendojmë se në projekt duhet të trajtohej edhe çështja e disa fjalëve (zakonisht me prejardhje të huaj), që diku përdoren si femërore e diku si mashkullore: *problema — problemi, diagrama — diagrami, ballona-balloni, argjila-argjili, terma-termi, tubi-tuboja, furra-furri* etj. Mendojmë se do të ishte mirë që të zgjidhnim vetëm variantin mashkullor: *problemi (problem i vështirë, problemi qëndron në..); diagrami (kurbat e diagramit); argjili (solucioni i argjilit dhe jo solucioni i argjilës, enë prej argjili dhe jo enë prej argjile)* etj., si dhe *balloni* dhe jo *ballona*. Për mendimin tonë, përjashtim duhet të bëjnë vetëm rastet: *rregulla-rregulli* dhe *rrjeta-rrjeti*, të cilat mendojmë se duhet të mbeten në përdorim me të dy variantet, sepse në praktikën e përditshme tashmë duket sikur kanë bërë vend të dy variantet: *Mos thyeni rregullat!*, por: *Në kaponon rregulli i brendshëm ishte në lartësinë e duhur; Ti, prishës i rregullit!* etj.; *Rrjetë për ushqime, rrjetë kërpi* etj., por: *Rrjeti uJOR dhe automobilistik, rrjeti i spiunazhit* etj.

21.

Në normën e sotme letrare kemi: *lër!, zër!, vër!, lër!, lëre!, lëri!, zër!, zëri!, vër!, vëre!, vëri!, lër një vend!, zër një vend!, zër një pozicion!, vër dy pika!, lëre macen!, zëre zogun!, vëre mënjanë!* etj. por jo si në projekt: *lërë!, vërë!, zërë!*, ose sipas H. Nishanit: *le!, ze!, ve!*